



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-057

Prishtinë, më 18 mars 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 MARS 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 26 shkurt 2016, në orën 14:30 dhe në orën 15:45, si dhe më 4 mars 2016.
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 26 shkurt 2016, në orën 14:30 dhe në orën 15:45, si dhe më 4 mars 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 4 mars 2016.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, pati vërejtje në procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 26 shkurt 2016, në orën 14:30 dhe në orën 15:45.

Procesverbalet janë korrigjuar sipas vërejtjeve të bëra nga nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 24 mars 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar,*
7. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të Skemës së Ndihmës Sociale për periudhën 2013-2015,*
8. *Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014,*
9. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit,*

10. Emërimi i një (1) anëtari të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015, mori këtë:

Vendim

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Arsim Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Nait Hasani, për të marrë pjesë në takimin e radhës së Komisionit të Përgjithshëm për Zhvillim Social, Edukim, Hulumtim dhe Shkencë, i Asamblesë Parlamentare të SEECp-së, i cili do të mbahet në Shqipëri, prej 8-10 prill 2016.

2. Shpenzimet e akomodimit për një natë mbulohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ndërsa shpenzimet e transportit dhe të akomodimit për natën e dytë, si dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Hagë (Holandë)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri: Muhamet Mustafa, Raif Qela dhe Blerim Grainca për të marrë pjesë në Konferencën Ndërparlamentare për Energji, e cila do të mbahet në Hagë, Holandë, prej 3-5 prill 2016.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi (me tejkalim të shpenzimeve në bazë të rezervimeve paraprake) për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kërkesa e znj. Grozdana Rakiq - bashkëshortja e ish-deputetit Velimir Rakiq për kompensim lidhur me rastin vdekjes së ish-deputetit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet kompensimi i dy pagave për shpenzimet e varrimit, si dhe kompensimi i të ardhurave mujore për një vit kalendarik me rastin e vdekjes së ish-deputetit Velimir Rakiq nga dita e pushimit të mandatit të ish-deputetit, Velimir Rakiq.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi të paguhen nga kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime, në emër të bashkëshortes së ish-deputetit, znj. Grozdana Rakiq, në llogarinë bankare: RaiffesenBank, nr.1503031001864864.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Budapest (Hungari)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Naser Osmani dhe Safete Hadërgjonaj, për të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare në Menaxhim, Ekonomiks dhe Marketing, e cila do të mbahet në Budapest (Hungari), prej 15-16 prill 2016.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi, si dhe shpenzimet e pjesëmarrjes në konferencë për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Kërkesa e pesë (5) deputetëve të Kuvendit për kompensimin e dëmeve materiale për dëmtimin e veturave të tyre në parkingun e Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e pesë (5) deputetëve të Kuvendit: Blerta Deliu, Besa Gaxherri, Naser Osmani, Adem Hoxha dhe Haxhi Shala, për kompensimin e dëmeve materiale në veturat e tyre në parkingun e Kuvendit të Kosovës, që kishte ndodhur me rastin e protestës, më 17 nëntor 2015.

7. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Buxhetin e Komunës së Klllokotit për vitin 2016

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e Buxhetit të Komunës së Klllokotit për vitin 2016, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i

Klllokotit, më 29 janar 2016, si dhe për rekomandimin dërguar Ministrisë së Financave që të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

8. Njoftimi i nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me punimet e Komisionit Drejtues dhe Komisionit të Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me Kosovën

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me punimet e Komisionit Drejtues dhe Komisionit të Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me Kosovën, të mbajtura më 4 mars 2016, në Paris (Francë).

9. Njoftimi i nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me letrën falënderuese të Sekretarit të Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të Mesdheut për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në këtë asamble

Kryesia u njoftua me shkresën e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me pranimin e letrës falënderuese nga Sekretari i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare të Mesdheut për pjesëmarrjen për herë të parë të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në këtë asamble.

10. Të ndryshme:

1. Shqyrtimi i kërkesës të Shoqatës e të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet pagesa në shumën prej pesë mijë (5000) euro për vitin 2016 për Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare për botimin e Revistës Mujore “Syri Ynë” në shkrimin BRAILLE për komunitetin e të verbërve, e cila do të shpërndahet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.

2. Shërbimet e telefonisë për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e shërbimeve të telefonisë për Kuvendin e Republikës së Kosovës, vendosi që shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile të vazhdojnë me operatorin e njëjtë si deri më tani.

3. Shpallja e konkurseve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e shpalljes së konkurseve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, mori këtë:

Vendim

Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, që me rastin e shpalljes së konkurseve nga Kuvendi, pagesën ta bëjë sipas modulit të aprovimit, pa procedura të prokurimit.

4. Përbërja dhe emërimi i deputetëve për anëtar në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me përbërjen dhe emërimin e deputetëve për anëtar në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim, mori këtë:

Vendim

I. Emërohen deputetët për anëtarë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, si në vijim:

1. Xhavit Haliti, kryetar (GP i PDK-së)
2. Sabri Hamiti, zëvendëskryetar (GP i LDK-së)
3. Adem Grabovci, anëtar (GP i PDK-së)
4. Besim Beqaj, anëtar (GP i PDK-së)
5. Ismet Beqiri, anëtar (GP i LDK-së)
6. Teuta Sahatqija, anëtare (GP i LDK-së)
7. Ilir Deda, anëtar (GP “Vetëvendosje”)
8. Glauk Konjufca, anëtar (GP “Vetëvendosje”)
9. Donika Kadaj-Bujupi, anëtare (GP i AAK-së)
10. Time Kadrijaj, anëtare (GP i AAK-së)
11. Valdete Bajrami, anëtare (GP “Nisma për Kosovën”)
12. Nenad Rashiqi, anëtar (GP Lista serbe)
13. Kujtim Paçaku, anëtar (GP “6+”)
14. Luljeta Veselaj-Gutaj, anëtare zëvendësuese (GP i PDK-së)
15. Muhamet Mustafa, anëtar zëvendësues (GP i LDK-së)
16. Slobodan Petroviq, anëtar zëvendësues (GP Lista serbe)

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale